



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 27 gusht 2013

Për: Isa Mustafa, Kryetar i Komunës së Prishtinës

Lënda: Kërkesë

I nderuar Kryetar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), duke u bazuar në mandatin e saj të përcaktuar në shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, me qëllim të zhvillimit të legjislacionit për vetëqeverisje efikase komunale, është duke punuar në ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-41 për Kufijtë Administrativ të Komunave.

Në kuadër të (Shtojcës I) të ligjit aktual Kufijtë Administrativ të Komunave në nenin 6 janë përcaktuar Zonat Kadastrale të të gjitha komunave të Republikës së Kosovës. Gjatë takimeve të mbajtura me autoritetet komunale përfshirë takimet me kryetar të komunave, kryesues të kuvendeve të komunave dhe zyrtar tjerë komunal kemi pranuar shqetësimet e disa kryetarëve të komunave, lidhur me mospërfshirjen e disa fshatrave në kuadër të zonave kadastrale.

Me qëllimim të pëfshirjes së tyre në Projektligjin i cili është duke u ndryshuar, kërkojmë nga Ju që të na dërgoni listën e fshatrave që nuk janë aktualisht të evidentuara në kuadër të zonave kadastrale të komunës suaj, të rënditura në (Shtojcën I) të Ligjit Për Kufijtë Administrativ të Komunëve.

Lutemi që listën e fshatrave që nuk janë evidentuara në (shtojcën I) të Ligjit aktual të na dërgoni jo më vonë se deri me datë 03 shtator 2013 në formë fizike në shkrimoren e MAPL-së apo në formë elektronike në emailin: agron.maxhuni@rks-gov.net, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave në MAPL.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është e gatshme të përgjigjet nëse keni ndonjë paqartësi në këtë kërkesë.

Bashkangjitur me këtë shkresë gjeni edhe listën e zonave kadastrale të komunës suaj të rënditura në (shtojcën I) të Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave

Me respekt,

Besnik Osmani,
Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së

Kopje: Slobodan Petrović, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,
Udhëheqësve të Departamenteve dhe
Arkivit të MAPL-së

Prishtinë KADASTRA

19 Hajkobillë

19 Hajvali

19 Ballaban

19 Barilevë

19 Besi

19 Busi

19 Dabishec

19 Nëntë Jugoviq

19 Bërnice i Poshtme

19 Dragoc

19 Drenoc

19 Glllogovicë

19 Bërnice e Epërme

19 Grashticë

19 Keçekollë

19 Kolovicë

19 Koliq

19 Kukavicë

19 Lebanë

19 Llukar

19 Makoc

19 Marec

19 Matçan

19 Mramor

19 Nishec

19 Novosellë

19 Orlloviq

22

19 Prishtinë

19 Prapashticë

19 Prugoc

19 Radashec

19 Rimanishtë

19 Sharban

19 Shashkoc

19 Siqevë

19 Slivovë

19 Sofali

19 Tenezhdoll

19 Trudë

19 Vranidoll

19 Zllatar

Cagllavicë